



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 12.10.2020)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:35 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)*
- 2. Maksim Qoku (zëvendëskryetar)*
- 3. Medi Bici (anëtar)*
- 4. Fatmira Luli (anëtare)*
- 5. Brunilda Kadi (anëtare)*
- 6. Dritan Hallunaj (anëtar)*
- 7. Ilir Toska (anëtar)*
- 8. Brikena Ukperaj (anëtar)*
- 9. Marçela Shehu (anëtare)*
- 10. Erjon Muharremaj (anëtar)*

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Alban Toro.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

2. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Valbona Bako, Specialiste pranë Sektorit të Përgatitjes së Dokumentacionit dhe Përfaqësimit në Gjykatë.

4. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Pasi verifikohet prezenca e anëtarëve të Këshillit, fillon mbledhja për trajtimin e çështjes “Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Shkurtimisht parashtrohet se nga Gjykata e Apelit Korçë, ditën e sotme, është paraqitur kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, me karakter “tepër urgjent”, në lëndë penale.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka këto propozime:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Gjithashtu Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: z.Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë të cilët kanë planifikuar gjykime më datë 13.10.2020 , pra ditën kur edhe Gjykata e Apelit Korçë ka planifikuar gjykimin e nëntë çështjeve në nevojë, konkretisht: znj. Maria Qirjazi; z. Asim Vokshi; znj. Valdete Hoxha; znj. Edlira Petri; z. Artur Kalaja; znj. Elbana Lluri; znj. Zegjine Sollaku; znj. Elona Toro.

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë që ka njoftuar pamundësinë e paraqitjes në detyrë për arsye shëndetësore, konkretisht: z. Genti Shala.

Në shortimin e çështje të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilës i është akorduar leje afatgjatë nga ish-KLD-ja, leje që ka përfunduar (më datë 01.04.2020), por që nga gjykata nuk ka ndonjë njoftim për kthimin e saj në detyrë, konkretisht: znj. Evjeni Sinojmeri.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Valbona Bako: Për 9 çështjet e Gjykatës së Apelit Korçë, përzgjidhet gjyqtari Gramoz Levanaj.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe kjo çështje e rendit të ditës.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor